

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Jemi mbi 80 punonjës të RTSH-së, që jemi tronditur papritur nga një komunikim për t'u larguar në mënyrë masive nga puna nga ky institucion, të cilin shumë prej nesh e kanë themeluar, kanë dhënë mundin dhe djersën e tyre, kanë punuar dhe kanë kontribuar prej dekadash të tëra.

Me respekt Përfaqësia e të larguarve

DREJTUAR: PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KRYETARES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË KRYETARIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT DELEGACIONIT TË KOMISIONIT EUROPIAN KËSHILLIT TË EUROPËS PREZENCËS SË OSBE - SË NË SHQIPËRI TRUPIT DIPLOMATIK TË AKREDITUR NË SHQIPËRI AVOKATIT TË POPULLIT KOMISIONIT PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK UNIONIT TË GAZETARËVE SHQIPTARË A.C.A.C

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Jemi mbi 80 punonjës të RTSH - së që jemi tronditur papritur nga një komunikim për t'u larguar në mënyrë masive nga puna nga ky institucion, të cilin shumë prej nesh e kanë themeluar, kanë dhënë mundin dhe djersën e tyre, kanë punuar dhe kanë kontribuar prej dekadash të tëra.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në bazë të parimeve mbi të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë institucionet që ju përfaqësoni, kërkojmë mbështetjen tuaj morale dhe institucionale për të na u njohur të drejtat tona për një trajtim dinjitoz, për një vlerësim të drejtës tonë për kryerjen e një reforme të ngritur mbi mirëbesimin mes palëve dhe për transparencën e kryerjes së reformave në mediat publike.

Grupimi jonë i kërkon me forcë drejtuesve të institucionit nisjen e bisedimeve si një e drejtë e pamohueshme për të kryer një reformë të mbarë nën vëzhgimin dhe ndihmesën e drejtëpërdrejtë tuajën.

Me Respekt

Përfaqësia e të larguarve,

Pjesë nga peticioni i të larguarve nga RTSH drejtuar institucioneve të shtetit




Foto nga shfaqja: "Berberi i Seviljes"

Erik Vinje ngjit në TK veprën franceze

"Berberi i Seviljes", një teatër i lirë

Nëse jeni mësuar ta shihni vetëm në opera, për herë të parë historia e "Berberit të Seviljes" vjen edhe në Teatrin Kombëtar. Duke shënuar kështu premierën e tretë të këtij sezoni, kjo shfaqje vjen nesër si premierë, nën regjinë e francezit Erik Vinje dhe me asistencën e Vasjan Lamit. Dje, gjatë një konference për shtyp, stafi që mori përsipër vënieën në skenë të kësaj komedie, shkruar nga francezi i mirënjohur Beaumarchais, bëri të ditur detajet rreth këtij bashkëpunimi ndërmjet teatrit dhe ambasadës franceze.

Historia

Në qendër të veprës është një grua, të cilën i shoqi me xhelozinë e tij dhe ndjenjën e inferioritetit që ka ndaj saj e ka burgosur dhe e mban të fshehur nga sytë e botës. Kjo është arsyeja që autori, Rozinën dhe Figaron, si edhe ambientet e shtëpisë së tyre i ka trajtuar të gjitha të mbuluara në të zezë. Ndërsa në të kundërt, Almaviva, i cili simbolizon dashurinë, si dhe Figaro, që në një farë mënyre është dirigjenti i strategjisë për t'u futur në këtë burg të zi dhe që aty të rrëmbejnë Rozinën, janë veshur në të bardha.

cilësuar dhe si vepra që me strukturën e saj moderne shënoi kalimin nga teatri klasik francez në atë modern. Ndërsa drejtori i Teatrit Kombëtar, Kristaq Skrami, u shpreh se është i pari bashkëpunim i frytshëm ndërmjet TK dhe ambasadës franceze. Në këtë komedi interpretojnë një kast aktorësh të njohur të Teatrit Kombëtar, si Luiza Xhuvani në rolin e Rozinës, Roland Trebicka në rolin e kontit Almaviva, Marko Bitraku në rolin e Don Bazilios, Helidon Fino në rolin e Figaros, Neritan Liçaj në rolin e Bartolos dhe Fadil Kujovskës në rolin e noterit. "Ideja kryesore e kësaj vepre është himnizimi dhe sakrificat që duhet të bëjë njeriu për të fituar dhe triumfuar në emër të dashurisë", theksoi regjisori. "Berberi i Seviljes" do të shfaqet këtë fundjavë në datat 20, 21, 22 prill në skenën e madhe të Teatrit Kombëtar në Tiranë.

Të larguarit, peticion presidentit dhe institucioneve kryesore shtetërore


Bum shkarkimesh në RTSH, mbi 80 punonjës

ANILA MEMA

Bum shkarkimesh në Radio Televizionin Shqiptar. Për herë të parë në historinë e këtij institucioni publik, jo pak, por mbi tetëdhjetë punonjës janë hequr nga puna.

Lajmi për largimin e tyre brenda muajit korrik u është bërë i ditur pesë ditë më parë si nga drejtuesit e televizionit, ashtu dhe nga ata të radios. "Ka qenë data 12 prill, kur Drejtorja e Përgjithshme e Radio-Televizionit na mblodhi duke na thënë tekstualisht: Ju jeni njerëzit që nuk do të punoni më në këtë institucion! Edhe pse u kemi kërkuar arsye, nuk na dhanë, duke u justifikuar se kjo është një reformë që duhet ndërmarrë", shprehen disa përfaqësues të të larguarve.


80



PUNONJES të Radio Televizionit Publik Shqiptar janë shkarkuar nga puna, pas një reforme të ndërmarrë pesë ditë më parë

eredaktorja Menada Zaimi, Elsa Xhai, Ferdinand Samarxhiu, Kleart Duraj, Gazmend Agalliu etj. Përveç tyre kjo reformë ka prekur nga largimet të gjithë sektorët e Radio Tiranës, TVSH-së, Drejtorisë së Informacionit dhe Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese. Sipas përfaqësuesve, komunikimi për largimin nga puna u është bërë në grupe me ndryshme. Madje disave prej tyre zyrtarisht me dokumentet përkatëse dhe disa të tjerëve vetëm verbalisht. Ndërkaq që afati i fundit i largimit të tyre nga ky institucion në bazë të Kodit të Punës, është lënë data 31 korrik i këtij viti. Pas kësaj reforme, punonjësit e RTSH-së që i ka

31




KORRIK është afati i fundit për punonjësit e RTSH që duhet të largohen nga puna. Ky afat është dhënë në bazë të Kodit të Punës.

prekur kjo reformë, kanë hartuar një peticion, të cilin ia drejtojnë presidentit të Republikës së Shqipërisë, kryetares së Kuvendit, kryetarit të këshillit të ministrave, komitetit shqiptar të Helsinkit, delegacionit të Komisionit Evropian, KE, prezencës së OSBE në Shqipëri, trupit Diplomatik të akredituar në Shqipëri, Avokatit të Popullit, Komisionit për edukimin dhe mjetet e informimit publik dhe unionit të gazetarëve shqiptarë. "Stafi krijues të vlerësonte pasurinë krijuese me një status të ri, të rriste rolin e punonjësve të këtij institucioni të vetëm publik dhe ky largim masiv nga puna në emër të një reforme pa ide është diskrimin-

uese. Nuk kuptohet se mbi ç'bazë është kryer kjo reformë. Nuk ekziston asnjë studim rreth nevojës së punonjësve, nuk ekziston asnjë impakt social që krijon. Madje nuk ekziston asnjë kriter rreth përzgjedhjes së punonjësve që janë në lsitën e të larguarve, ka të rinj apo të vjetër, profesionistë të vlerësuar qoftë edhe me tituj, figura publike që kanë portretizuar këtë institucion për vite me radhë", shprehen ata, duke theksuar se ndër ata që vazhdojnë të punojnë ende në RTSH janë disa të rinj pa arsimimin e duhur dhe pa eksperiencën përkatëse. "U perfeksionuan metodat prej gestapoje të prerjes së kokave natën vonë me kohë të keqe dhe ankthi e paniku vazhdon, pasi ajo reformë është kryer në fshehtësi të plotë, larg mendimit të lirë dhe vizionar të specialistëve profesionistë", shtojnë përfaqësuesit të larguarve nga RTSH. Në peticionin e tyre shkruhet se largimet pa kriter dhe të befasishme nuk sjellin asgjë tjetër përveçse ndërtimin e marrëdhënieve të punës mbi presionin, kompromiset e detyrura, kulisat, klanet dhe interesat e tjera, përfundojnë përfaqësuesit, me shpresën se dikush mund t'u japë të drejtë.

Ministria në ditën e trashëgimisë

Ministria e Kulturës, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve ka ndërmarrë një sërë projektesh për ditën e sotme: duke e nisur nga parqet kombëtare arkeologjike, me një aktivitet për njohjen e vlerave të qytetit antik të Bylisit, prezantimin e librit "Stadiumi i Amantias, ndërtim ilir ndër më të rrallët në Ballkan", ku do të mbahen kumtesa dhe referate me profesorë nga Universiteti i Vlorës. Ndërsa në Gjirokastrë, specialistë të ndryshëm të IMK-së do të kenë takime me studentët e universitetit të këtij qyteti. Gjithashtu po në qytetin e gurtë do të përrurohet porta dhe tabelat hyrëse të parkut të Antigonesë. Në Korçë do të çelet një ekspozitë me objekte të rralla, kurse në Tiranë një ekspozitë fotografike e monumenteve të kulturës nga e tërë Shqipëria.



Violina e Ughi pushton TOB

Për të dytën herë ngjitet në skenën shqiptare. Me violinën e tij, Ugo Ughi interpreton sot në mbremje në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit. I shoqëruar nga pianisti Alessandro Specchi, dy artistët do të interpretojnë për më se një orë pjesë nga një repertori i zgjedhur, duke filluar me Gaetano Pugnani dhe Fritz Kreisler, sonata në la maxhor op 47 e Beethovenit, sonata solo për violinë e Eugene Ysaye dhe në mbyllje, një introduktë nga Camille Saint-Saens dhe Fantazi për Karmenin nga Pablo de Sarasate. Ughi njihet për interpretimet e tij me orkestrat më të njohura simfonike të botës, duke nisur me Concertgebouw të Amsterdamit, Boston Symphony Orchestra, Philadelphia Orchestra, New York Philharmonic, Washington Symphony Orchestra etj., nën drejtimin e mjeshtrëve si: Sargent, Celibidache, Colin Davis, Leitner, Masur, Chung, Ceccato etj. Koncerti nis sot në orën 19:00.

